

Ne perputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit
ky dokument perben:

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

I

SHOQERISE

"DELTA HOLDING" SHPK

TIRANE / SHQIPERI

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

i

Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

"DELTA HOLDING" SHPK

KAPITULLI

Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1. Data e Themelimit dhe Emri

- 1.1 Me efekt nga data **11.01.2023** themelohet shoqeria "**Delta Holding**" (ne vijim "**Shoqeria**"), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "**SHPK**", i cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
- 1.2 Ortaket e Shoqerise ("**Ortaket**") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuota.
- 1.3 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:
 - (i) fjalet "**Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar**" ose "**SHPK**";
 - (ii) numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj;
 - (iii) adresa e regjistruar, dhe
 - (iv) dhe pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.

Neni 2. Forma dhe Baza Ligjore

- 2.1 Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne perputhje me kete Akt Themelimi dhe Statut te nenshkruar ndermjet Ortakeve te Shoqerise, Marreveshjen e Ortakeve dhe Pronareve Perfitues e dates 11.01.2023 ("**Marreveshja e Ortakeve**") si dhe legjislacionin shqiptar. Ne rast se parashikimet e ketij Akt Themelimi dhe Statuti bien ne kundersizim me ato te Marreveshjes se Ortakeve, parashikimet e Marreveshjes se Ortakeve do te kene perparesi.
- 2.2 Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("**shoqeri me pergjegjesi te kufizuar**"), ne perputhje me ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "**Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ("Ligji i Shoqerive")**".
- 2.3 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

Neni 3. Zyra Qendrore

Zyra qendrore e Shoqerise ndodhet ne adresen: Autostrada Tirane - Durres, km. 3, zona kadastrale 2679, nr.pasurie 19/27/1, Mezez, Kashar, Tirane, Shqiperi. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

<p>Neni 4. <u>Kohezgjatja</u></p> <p>4.1 Veprimtaria e Shoqerise fillon pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.</p> <p>4.2 Kohezgjatja e Shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar.</p>
<p style="text-align: center;"><u>KAPITULLI II</u> <u>Objekti</u></p>
<p>Neni 5. <u>Objekti i Shoqerise</u></p> <p>5.1 Objekti i aktivitetit te Shoqerise, perfshin por nuk kufizohet me sa me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Themelimi, krijimi dhe administrimi i shoqerive dhe siper marrjeve shqiptare dhe te huaja si dhe pjesemarrja ne to; b) Blerja apo disponimi mbi pjesemarrjen e kapital ne korporata, partneritete apo shoqeri e sindikata me objekte aktiviteti te ndryshme; blerja dhe shitja e aksioneve dhe kuotave apo pjesemarrje te tjera ne siper marrje dhe shoqeri, brenda kufijve te lejuar nga legjislacioni i aplikueshem; c) Blerja, barresimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive te paluajtshme dhe atyre te luajtshme si dhe titujve; d) Konsulence ne fushen e investimeve te huaja dhe vendase. <p>5.2 Shoqeria mund te kryeje dhe te realizoje çdo aktivitet qe lidhet direkt apo indirekt, eshte si rrjedhim apo ka te beje me aktivitetet e renditura me siper, si dhe mund te ushtroje edhe çdo lloj aktiviteti tjeter te pashprehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.</p>
<p>Neni 6. <u>Ndryshime</u></p> <p>Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne çdo kohe siç parashikohet ne kete Statut.</p>
<p style="text-align: center;"><u>KAPITULLI III</u> <u>Kapitali i regjistruar, Kuotat dhe Zoterimi i tyre</u></p>
<p>Neni 7. <u>Kapitali i regjistruar i shoqerise</u></p> <p>7.1. Kapitali i regjistruar i Shoqerise eshte € 50,000 (pesedhjte mije euro) ose i konvertuar me kursin zyrtar te Bankes se Shqiperise, ne daten e nenshkrimimit te ketij akti 5,693,500 (pese milion e gjashteqind e nentehjete e tre mije e peseqind) leke plotesisht te nenshkruara nga ortakët. Shlyerja e kapitalit do te behet brenda 60 diteve nga nenshkrimi i ketij akti themelimi dhe statuti.</p> <p>7.2. Kapitali i Shoqerise eshte shlyer nga Ortakët, ne proporcion me pjeset e tyre takuese.</p> <p>7.3. Kapitali i Shoqerise perbehet nga 2 (dy) Kuota, secila prej tyre me vlere € 25,000 (njezet e pese mije euro) ose i konvertuar me kursin zyrtar te Bankes se Shqiperise, ne daten e nenshkrimimit te ketij akti, 2,846,750 (dy milion e teteqind e dyzet e gjashte mije e shtateqind e pesedhjte) leke.</p>
<p>Neni 8. <u>Ortakët e Shoqerise dhe Kuotat</u></p> <p>8.1 Ortakët e Shoqerise dhe kuotat e zoteruar prej tyre ne Shoqeri jane si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) z. Dorian Sadiku, zoterues i 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 50% te kapitalit te regjistruar te shoqerise (te dhenat e ortakut pasqyrohen ne ID bashkelidhur ketij akti); (ii) z. Eduard Curraj, zoterues 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 50% te kapitalit te regjistruar te shoqerise (te dhenat e ortakut pasqyrohen ne ID bashkelidhur ketij akti).

8.2 Pranimi i ortakeve te rinj ne shoqeri behet ne perputhje me dispozitat e Marreveshjes se Ortakeve dhe Pronareve Perfitues e dates 11.01.2023 ("**Marreveshja e Ortakeve**").

Neni 9. Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit te Shoqerise

- 9.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te Shoqerive.
- 9.2 Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.
- 9.3 Rritja e kapitalit do te behet me kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlera e tyre nominale do te paguhet plotesisht.
- 9.4 Zmadhimi i kapitalit nuk do te dobesoje pjeset e interesit te Ortakeve ne Kapitalin e Shoqerise, pervecse kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, vendim i cili do te merret me nje shumice prej $\frac{3}{4}$ e votave.
- 9.5 Me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Asambleja e Pergjithshme mund te autorizoj Administratorin te bee blerjen e kuotave perkatese apo pjese te tyre dhe t'i anulojne ato.

Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

- 10.1 Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuotat e Shoqerise.
- 10.2 Çdo Ortak do te kete te dejta vote ne Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise ("**Asambleja e Pergjithshme**") ne perpjestim me vleren nominale te kuotes qe zoteron. Çdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, nese Asambleja e Pergjithshme vendos te shperndaje fitimet, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, per çdo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligjit te Shoqerive.
- 10.3 Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne çdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.
- 10.4 Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne pergjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne. Ortaket nuk mbajne pergjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata realizojne).
- 10.5 Pergjegjesia dhe kufizimi i pergjegjesise se Shoqerise do te jete ne perputhje me dispozitat respektive qe parashikojne keto pergjegjesi dhe kufizime te pergjegjesive ne legjislacionin Shqiptar.

Neni 11. Transferimi i Kuotave

Transferimi i kuotave te Ortakeve ose i pjeseve te tyre do te kryhet vetem ne perputhje me kushtet procedurat e parashikuara ne Marreveshjen e Ortakeve dhe Pronareve Perfitues e dates 11.01.2023. ("**Marreveshja e Ortakeve**").

KREU IV
Asambleja e Pergjithshme

Neni 12. Kompetencat / Kuorumi

- 12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

- 12.2 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.
- 12.3 Ortaket bien dakord se e drejta e votes ne Asamblene e Pergjithshme do te jete ne proporcion me zoterimin e kuotave nga secili Ortak. Secila Ortak ka te drejte te propozoje çeshtje qe do te perfishihen ne rendin e dites se Asamblese se Pergjithshme.
- 12.4 Ortaket pranojne se asnje vendim i vetem i Asamblese se Pergjithshme nuk mund te behet pa kuorumin e kerkuar, si me poshte vijon:
- (a) ne rastin e marrjes se vendimeve, te cilat kerkojne nje shumice te zakonshme, mbledhja e Asamblese se Pergjithshme eshte e vlefshme vetem nese mbledhja eshte thirrur sipas menyres e afateve te percaktuara ne statut dhe ne mbledhje marrin pjese personalisht ose te perfaqesuar ortaket me te drejte vote te cilet zoterojne te pakten 51 % (per qind) te kuotave te kapitalit te shoqerise. Vendimet e kesaj mbledhje jane te vlefshme nese per to votojne pro ortaket prezent ne mbledhje te cilet zoterojne 51 % (per qind) te kuotave te kapitalit te shoqerise;
- (b) ne rastin e marrjes se vendimeve, te cilat qe kerkojne nje shumice te cilesuar mbledhja e Asamblese se Pergjithshme eshte e vlefshme vetem nese mbledhja eshte thirrur sipas menyres e afateve te percaktuara ne statut dhe ne mbledhje marrin pjese personalisht ortaket me te drejte vote te cilet zoterojne 75% (per qind) te kuotave te kapitalit te shoqerise. Vendimet e kesaj mbledhje jane te vlefshme nese per to votojne pro ortaket prezent ne mbledhje te cilet zoterojne 75 % (per qind) te kuotave te kapitalit te shoqerise.
- 12.5 Ne rast se Asambleja e thirrur rregullisht nuk arrin te mblidhet per mungese te kuorumit te parashikuar ne pikat (12.4)(a) dhe (12.4)(b) e per rrjedhoje nuk mund te marre vendimet per te cilat eshte thirrur, atehere, u njoftohet te gjithë ortakeve se do te mbahet nje mbledhje e re brenda 15 (pesembedhjetë) ditësh me te njejtin rend dite. Ne rast se edhe pas kesaj thirrje te dyte Asambleja nuk arrin te mblidhet per mungese te kuorumit te parashikuar ne pikat (12.4)(a) dhe (12.4)(b) e per rrjedhoje nuk mund te marre vendimet per te cilat eshte thirrur, atehere, u njoftohet te gjithë ortakeve se do te mbahet nje mbledhje e re brenda 20 (njetzet) diteve me te njejtin rend dite. Asambleja ne kete mbledhje te trete do te quhet se eshte mbledhur rregullisht edhe nese nuk arrihet kuorumi per vlefshmerine e mbledhjes se parashikuar ne piken (12.4)(a) dhe (12.4)(b), megjithate vendimet do te jene te vlefshme vetem nese merren me perqindjen e kuorumit te vendimmarjes te ortakeve prezent ne mbledhje te parashikuar ne pikat (12.4)(a) dhe (12.4)(b) (sipas llojit te vendimit per te cilin eshte thirrur mbledhja).

Neni 13. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.
- 13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 13.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjetër aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjithë aseteteve te Shoqerise, siç rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet Asamblese, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- 13.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje Ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, siç rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 13.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

- 13.6 Ortaket do te organizojne takime me Administratorin te pakten nje here ne vit me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga Administratori, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre, perfshire ceshtje per te cilat Administratori nuk bien dakord.
- 13.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e Administratoreve.

Neni 14. Menyra e Thirrjes se Mbledhjeve

- 14.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.
- 14.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga Administratori (ose nje prej Administratoreve nese do te kete disa te tille) ose nga çdonjeri prej Ortakeve, sipas parashikimeve te legjislacionit ne fuqi.
- 14.3 Asambleja e Pergjithshme si rregull mblidhet ne zyren qendrore te Shoqerise, por mund te blihet ne çdo qytet apo province te botes siç bihet dakord midis Ortakeve.
- 14.4 Njoftimi me shkrim per çdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme do te percaktoje vendin, daten dhe oren e çdo takimi, rendin e dite dhe natyren e biznesit per te cilin do kryhet transaksioni. Njoftimet do tu behen Ortakeve me poste te regjistruar, ne librin e ortakeve, te pakten 7 dite para mbledhjes dhe jo me shume se 60 dite para dates se percaktuar. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithë Ortaket bien dakord.
- 14.5 Asambleja e shoqerise meme "DELTA HOLDING" SHPK mund te mbahet me ane te perdorimit te konferences telefonike, me video ose pajisje komunikimi te ngjashme per sa kohe qe te gjithë Ortaket te cilet marrin pjese ne kete mbledhje mund te identifikojne njeri tjetrin ne kohen e kesaj mbledhje. Ne rastin e zhvillimit te mbledhjeve nepermjet konferences ndiqet procedura e meposhtme:
- (a) Ortaket mund te marrin pjese dhe te votojne ne mbledhje nepermjet komunikimit me mjete elektronike. Adresat e komunikimit elektronik (email) si dhe adresat ku do te mbahen video konferencat, i njoftohen Administratorit te shoqerise, i cili i regjistron ato ne regjistrin perkates, krahas emrave te ortakeve. Njoftimi per mbledhjen dhe rendin e dites dergohet ne adresat e ortakeve sipas percaktimeve te statutit. Çdo ndryshim ne keto adresa do te duhet t'i njoftohet Administratorit.
- Mos njoftimi i ndryshimit te adreses/adresave nga ortaku/et, eshte pergjegjesi e ortakut/eve dhe njoftimet e derguara apo mbledhjet e zhvilluara ne adresat e deklaruara, do te jene te vlefshme dhe çdo pretendim per pavlefshmeri per efekt ndryshimi adrese te pa njoftuar, do te jete NUL.
- (b) Per zhvillimin e mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme, nepermjet konferences, per vendime qe kane te bejne me veprimtarine e zakonshme dhe te perditshme te shoqerise, si dhe vendime te listuara ne seksionin 3.03 me siper por per te cilat nuk nevojitet pasqyrimi i tyre ne fletet e regjistrit te shoqerise prane QKB, procesverbali i mbledhjes dhe identifikimi e pasqyrimi i ortakeve prezent ne mbledhje do te behet nga Administratori i shoqerise. Administratori mban dhe pasqyron sakte procesverbalin e mbledhjes dhe vendimmarrjet perkatese. Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet ne fund nga Administratori. Administratori mbi bazen e procesverbalit te mbledhjes perpilon vendimin perkates te Asamblese se Pergjithshme dhe ua dergon nepermjet adreses elektronike te gjithë Ortakeve se bashku me procesverbalin perkates te nenshkruar prej tij. Secili prej Ortakeve, nenshkruan vendimin perkates (me nenshkrim te zakonshem ose nenshkrim elektronin, nese posedojne te tille) dhe ia njoftojne vendimin e nenshkruar Administratorit dhe ortakeve te tjere te shoqerise po nepermjet adreses elektronike.
- 14.6 (c) Per zhvillimin e mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme, nepermjet konferences, per vendime qe kerkojne nje shumice te cilesuar sipas seksionit 3.03 dhe per te cilat nevojitet pasqyrimi i tyre ne

fletet e regjistrit te shoqerise prane QKB, procesverbali i mbledhjes dhe identifikimi e pasqyrimi i Ortakeve prezent ne mbledhje behet nga Adminsitratori i shoqerise me prezencen e nje noteri publik. Administratori mban dhe pasqyron sakte procesverbalin e mbledhjes dhe vendimmarrjet perkatese. Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet ne fund nga Adminsitratori i shoqerise dhe nenshkrimi i tij vertetohet nga Noteri Publik prezent ne mbledhje. Administratori mbi bazen e procesverbalit te mbledhjes perpilon vendimin perkates te Asamblese se Pergjithshme dhe ia dergon ate nepermjet adreses elektronike te gjithe Ortakeve si dhe Noterit Publik, se bashku me procesverbalin perkates. Secili prej Ortakeve, nenshkruan vendimin perkates (me nenshkrim te zakonshem ose nenshkrim elektronik, nese posedojne te tille) dhe ia njoftojne vendimin e nenshkruar Administratorit, ortakeve te tjere dhe Noterit Publik po nepermjet adreses elektronike. Ky i fundit verteton sipas ligjit, vendimin e nenshkruar prej secilit Ortak te shoqerise.

Neni 15 Vendimet e Rendesishme

Ortaket pranojne se vendimet e listuara me poshte do te jene nen juridiksionin ekskluziv te Asamblese dhe do te konsiderohen si vendime qe merren me nje shumice te cilesuar sipas parashikimeve te nenit 12.4, germa (b):

1. ndryshimi i dispozitave te statutit/eve te shoqerise/ve;
2. rritja dhe zvogelimi i kapitalit te nenshkruar te shoqerise/ve;
3. emetimi i bondeve ose borxheve (debt securities) te tjera te cilat mund te çojne ne rritjen e borxheve te shoqerise/ve;
4. dhenia hua tek ortaket;
5. marrja e kredive dhe e huave;
6. çdo lloj shitje, caktimi ose transferimi te operacioneve aktuale te shoqerise/ve tek nje pale e trete;
7. riorganizimi, prishja dhe ç'regjistrimi i shoqerise/ve;
8. ndryshimi i formes ligjore te shoqerise/ve (p.sh shnderrimi ne nje shoqeri anonime);
9. shperndarja e fitimeve/dividenteve;
10. largimi i ortakut;
11. shitja e kuotave apo aktivitetit tregtar te shoqerive bija apo shoqerive te zoteruara prej shoqerive bija te grupit te shoqerive "DELTA HOLDING" SHPK;
12. blerja e kuotave te nje shoqerie te re apo blerja e nje aktiviteti tregtar te ushtruar nga nje shoqeri tjetere apo nga vete shoqerite e grupit te shoqerive "DELTA HOLDING" SHPK;
13. blerja e pasurive te paluajtshme ne emer te seciles prej shoqerive te grupit te shoqerive "DELTA HOLDING" SHPK;
14. shitja e pasurive te paluajtshme ne emer te seciles prej shoqerive te grupit te shoqerive "DELTA HOLDING" SHPK;
15. kryerja e investimeve ne pasuri te paluajtshme ne secilen prej shoqerive te grupit te shoqerive "DELTA HOLDING" SHPK.

Neni 16 Perjashtimi nga e drejta e votes

16.1 Nje Ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:

- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

16.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

KREU V
Administratoret

Neni 17. Administratoret dhe kompetencat

17.1 Shoqëria drejtohet nga Administratori(et). Administrator mund të jetë një individ i çdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jetë rezident në Shqipëri.

17.2 Administrator i parë i Shoqërisë është:

- Znj. Ewa Maria Kokot, lindur me 18.05.1962, në Czestochowa, Poloni, dhe rezidente në Shqipëri, në adresën rruga "Tish Daia", hyrja 2, ap. 49, Tiranë, (të dhënat e administratorit pasqyrohen në pasaportën bashkëlidhur këtij akti).

17.3 Administratoret do të emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme me vendim me një shumicë të zakonshme. Administratoret do t'i kushtojnë të gjithë kohën e punës dhe përpjekjet të tyre ndaj Biznesit dhe punëve të Shoqërisë.

17.4 Administratori do të emërohet për një afat deri në pesë vjet, sipas Vendimit që do të marrë Asambleja e Përgjithshme në momentin e emërimit. Administratori mund të rrimërohet në detyrë pas mbarimit të mandatit të tij. Administratori i parë i shoqërisë do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 1 (një) vjeçare.

17.5 Menjëherë pas pranimit të emërimit të tij/tyre, Administratori(et) njohin se marrëdhënia e tyre me Shoqërinë ndërtohet mbi baza mirebesimi; lidhur me këtë vendim për heqjen e tyre nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Ortakëve gjykohej si arsye e ligjshme për shkarkimin e tyre, në përputhje me ligjet përkatëse.

Neni 18 Kompetencat dhe detyrimet

18.1 Administratori/et i shoqërisë raportojnë në mënyrë direkte dhe ekskluzive tek Ortaket dhe zbaton/jnë të gjithë urdhrat dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/et do të kryejnë të gjitha detyrat në përputhje me parashikimet e statutit të shoqërisë, akteve të brendshme të shoqërisë, planet e biznesit dhe politikave të percaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Të gjithë punëmarësit e Shoqërisë do të raportojnë të Administratoret ose të personat e percaktuar nga ato.

18.2 Kompetencat e Administratorit (eve) në kuadër të përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë:

- thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme;
- menaxhimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë/ve nëpërmjet zbatimit të politikave dhe planeve të percaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- drejtimi i operacioneve dhe administrimi i përditshëm i shoqërisë, dhenien e udhëzimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në shoqëri;
- kryerja e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin dhe aktet nenligjore në fuqi;
- përfaqësimi i shoqërisë;
- monitorimi dhe kontrolli i të gjithë shpenzimeve të shoqërisë;
- mbajtja në mënyrë të përshtatshme e dokumentave dhe librave kontabel të shoqërisë;
- raportimi periodik tek ortaket e shoqërisë mbi ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë, të ardhurave dhe shpenzimeve;
- kryerja e regjistrimeve dhe dërgimi i të dhënave të detyrueshme tek institucionet shtetërore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- përparatja dhe nënshkrimi i bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe paraqitja e tyre për miratim tek Asambleja e Përgjithshme;

- punesimi i punemarresve te shoqerise dhe monitorimi i tyre si dhe verifikimi konstant i kompetencave te punemarresve dhe kryerja prej tyre e punes ne perputhje me politikat e shoqerise, akteve te brendshme te shoqerise dhe ligjit.
- mbajtjen e korrespondences se shoqerise;
- dhenien e autorizimit per blerjen e mallrave apo sherbimeve te zakonshme te cilat lidhen ne menyre direkte me punen e perditshme te shoqerise, ne perputhje me faturat perkatese per kryerjen e ketyre pagesave;
- dhenien e autorizimit per kryerjen e transferimeve bankare nga llogarite e shoqerise lidhur me pagimin e taksave, tatimeve apo detyrimeve te tjera te shoqerise ndaj institucioneve shteterore, ne perputhje me dokumentin per pagese te leshuar nga institucionet;
- perpilimi dhe nenshkrimi i faturave tatimore qe do leshohen nga shoqeria si rezultat i puneve te kryera;
- kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

18.3 Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

18.4 Administratori, zyrtaret e tjere si dhe te punesuarit e Shoqerise do te pergatisin dhe do te implementojne politikat e administrimit sipas dhe ne perputhje me politikat e pergjithshme dhe programet e miratuara te Asamblese, Planit te Biznesit dhe Buxhetit.

18.5 Pervec se kur kerkohet ndryshe nga Ortaket, Administratori do te marrin pjese ne Mbledhjet e asamblese se Ortakeve. Çdo Ortak mundet gjithashtu te kerkoje qe Administratori te marrin pjese ne mbledhjet e Asamblese.

Neni 19 Kufizimet e Kompetencave te Administratoreve

19.1 Administratori nuk mund te kryejne aktivitetet e meposhtme pa miratimin paraprak me shkrim te Asamblese se Pergjithshme:

- te kryeje detyra te cilat jane ne kompetencen e Asamblese se Pergjithshme;
- te lidhe çdo lloj marreveshje, kontrate apo te kryeje transaksione te cilat jane jashte fushes se aktivitetit tregtar te shoqerise;
- te barresoje operacione te shoqerise, fonde te saj, asetete (qofshin keto te luajtshme ose te paluajtshme);
- te kryeje investime kapitale ose te disponoje mbi asetete (qofshin keto te luajtshme ose te paluajtshme) per te cilat nuk eshte dhene miratim ne buxhetin dhe ne Planin e Biznesit vjetor nga Asambleja e Pergjithshme;
- te ndryshoje strukturen organizative te shoqerise;
- te percaktojte dhenien e bonuseve ose shperblimeve te çdo natyre per punemarresit e shoqerise, kur keto bonuse apo shperblime tejkalojne 20% te pages vjetore te punemarresit;
- te marre kredi ose qira financiare ne emer te shoqerise;
- te miratoje dhenien e huave apo kredive tek ortaket apo palet e treta;
- te bleje, te marre, te shese apo te tranferojte pasuri te luajtshme apo te paluajtshme te shoqerise, apo çdo lloj tjetere kontrate qe ka shoqeria;
- te jape garanci, siguri ose kompensim per permbushjen e detyrimeve ose per marrjen e angazhimeve ndaj paleve te treta;
- te leshoje kambiale ne emer e per llogari te shoqerise, me perjashtim te atyre qe leshohen per aktivitetin normal te biznesit.

Neni 20 Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

- 20.1 Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, Administratorët detyrohen:
- (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
 - (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
 - (iii) te vleresojne me pergjegjesi cheshtjet per te cilat merret vendim;
 - (iv) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
 - (v) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem
- 20.2 Administratorët gjate kryerjes se detyrave te tyre pergjigjen kundrejt Shoqerise per çdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.
- 20.3 Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise çdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
- 20.4 Ne veçanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundërshtim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e meposhtme:
- (i) i kthen Ortakeve kontributet;
 - (ii) i paguan Ortakeve interesa apo dividende;
 - (iii) shperndan asetet Shoqerise;
 - (iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;
 - (v) jep hua.

KREU VI
Administrimi Financiar i Shoqerise

Neni 21. Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 21.1 Ortaket mund te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar per t'i sherbyer Shoqerise.
21.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII
Aktiviteti i Shoqerise

Neni 22. Viti ekonomiko-financiar

Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-te te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

Neni 23. Mbajtja e Llogarive

Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 24. Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

24.1 Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, Marreveshjen e Ortakeve dhe me ligjet e zbatueshme.

24.2 Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.

24.3 Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

- (i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
- (ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem.

24.4 Administratori(et) leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 24.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, Administratori(et) nuk mund ta leshojne kete certifikate.

24.5 Administratoret pergjigjen ndaj Shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

KREU VIII

Prishja

Neni 26. Prishja e Shoqerise

26.1 Shoqeria do te mbyllet dhe aktiviteti i saj do te perfundoje, sapo te ndodhe nje nga ngjarjet e permendura me poshte: (secili prej tyre do te perbeje nje "Ngjarje Mbyltese"):

- a) nje vendim i Asamblese se Pergjithshme per kete qellim;
- b) me vendim gjykate;
- c) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

26.2 Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

KREU IX

Te ndryshme

Neni 27. Largimi i Ortakut


25.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga nenet 101, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 28 Te tjera


26.1. Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi dhe Statut ose në Marrëveshjen e Ortakeve, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë.

**Nenshkrimi
I Themeluesve/Ortakeve**

Eduard Curraj



Dorian Sadiku



KRRIJ
I shoqërisë